

## Raport Muaji Nëntor 2021

### Informacion bazë

Administrimi i Fondit **Shoqëria Raiffeisen Invest sh.a**

Monedha **Euro**  
Datë Lancimi **22 Nentor 2012**

Vlera fillestare e kuotës **100**  
Shuma fillestare minimale **250**  
Shuma minimale pasuese **50**

### Komisione dhe Tarifa

Tarifë në hyrje **0.00%**  
Tarifë në dalje **0.00%**  
Tarifë Administrimi në vit **Deri ne 1.30% e vleres neto te aseteve**

Tarifa te tjera te vazhdueshme **Referojuni prospektit te fondit**

Komisione/tarifa të vazhdueshme **1.50% per vitin 2020**

Kosto për transfertë fondesh nga palë të treta **Referojuni informacionit ne degët e RBAL**

### Objektivi i investimit dhe profili i investitorit

Objektivi i Fondit është të mund t'i sigurojë investitorit një kthim nga investimi në përputhje me një menaxhim të kujdesshëm të portofolit duke ruajtur nivelin e kapitalit dhe likuiditetit të nevojshëm.

Nje pjese e rendesishme e asetëve të fondit mund të investohen në bono dhe obligacione thesari të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, të emetuara në monedhën euro. Megjithatë, frekuenca e emetimeve në euro nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë do të përcaktojë shkallën në të cilën Fondi do të investojë në këto lloje instrumentash.

Fondi është i përshtatshëm për individë dhe subjekte juridike të cilët mendojnë se objektivi i investimit i Fondit përputhet me kërkesat dhe pritshmëritë e tyre.


Shifra e tarifave të vazhdueshme 1.50% mbështetet në shpenzimet për vitin e mbyllur më 31.12.2020. Kjo shifër mund të ndryshojë nga viti në vit. Tarifa totale e vazhdueshme nuk mund të kalojë maksimumin prej 1.6% në vit të vlerës neto të asetëve të fondit.

Kostot e transaksioneve janë sipas kushteve të punës të palëvendërmjetësuese dhe nuk përfshihen në llogaritjen e komisioneve dhe tarifave të vazhdueshme, por ato i ngarkohen Fondit.

### Profili i Rrezikut dhe Përfitimit

Rrezik i ulët  
Përfitimet tipike më të ulëta

Rrezik i lartë  
Përfitimet tipike më të larta



### Fondi Raiffeisen Invest Euro është në kategorinë e tretë të Profilit të Rrezikut dhe Përfitimit

Treguesi i rrezikut dhe përfitimit korrespondon me një numër të plotë i cili përdoret për të renditur fondin në një nivel rreziku nga 1 në 7, sipas nivelit të rritjes të luhatshmërisë. Kategoria më e ulët nuk do të thotë që investimi në fond është pa rrezik.

Ky tregues ka për qëllim tju informojë mbi luhatshmërinë e çmimit të kuotës së fondit bazuar në historikun e performancës së fondit. Të dhënat historike të përdorura për llogaritjen e treguesit nuk mund të përbëjnë një siguri të plotë për profilin e rrezikut në të ardhmen.

## Të dhëna për Fondin në 30 Nëntor 2021



<b>Vlero Neto e Aseteve</b>	<b>67,723,128</b>
<b>Numri I Investitoreve</b>	<b>2,880</b>
<b>Cmimi I Kuotes</b>	<b>116.6992</b>
<b>*Kthimi Vjetor nga Investimi (30.11.2020 – 30.11.2021)</b>	<b>-0.91%</b>

\*Komisioni i administrimit zbritet përpara llogaritjes së kthimit nga investimi

## Struktura e Portofolit të investimeve më 30 Nëntor 2021

Portofoli i fondit Euro është ndërtuar në një mënyrë të tillë që të përfitojë nga balancimi i kategorive të ndryshme të investimeve në bono dhe obligacioneve qeveritare dhe të korporatave. Kjo bëhet me qëllim për të diversifikuar portofolin dhe ulur rrezikun që vjen nga ekspozimi i gjere ndaj pak instrumenteve.

Përçindja e alokimit të asetëve bëhet në përputhje me politikën e investimit dhe kritereve të specifikuar në prospektin e fondit. Shpërndarja e asetëve mund të jetë jashtë objektivit të përcaktuar për shkak të ndryshimeve të kushteve të tregut. Asetet e Fondit janë të investuara në instrumente financiare që i përkasin emetuesve që performojnë në industri të ndryshme të ekonomisë duke bërë të mundur rritjen e diversifikimit të portofolit.



Obligacionet të quajtura “dytësore” (ose me termin financiar subordinated) janë përafërsisht 6.12% e portofolit, në fund të Nëntorit. Duke iu referuar strukturës së portofolit të investimeve të fondit më 30 Nëntor 2021, përçindja e asetëve të fondit e

investuar në Obligacione Shtetërore qëndron në 40.2% të asetëve, dhe 37.9% e tyre i përkasin obligacioneve të Qeverisë Shqiptare, të tregtuar në tregje ndërkombëtare. Fondi mund të balancojë ekspozimin ndaj instrumenteve të ndryshme në varësi të kushteve të tregut për të arritur objektivat e tij afatgjatë.


Asetet e fondit të investuara në obligacione të korporatave me vlerësime të larte janë 29.4% e asetëve dhe investimet në Fondet e Investimeve janë 26.8% e totalit të aktiveve. Keto fonde investimi gjithashtu kanë në fokus investime në tregun e obligacioneve. Likuiditeti i mbajtur në cash dhe depozita qëndron në nivelin 3.6% e totalit të asetëve të fondit.

Vlera neto e asetëve të fondit është në nivelin 67.72 milion EUR në fund të muajit Nëntor.

## Performanca e fondit dhe ecuria e çmimit të kuotës gjatë muajit Nëntor


Gjatë muajit Nëntor çmimi i kuotës ka rënë me **-0.81%** në krahasim me muajin e mëparshëm. Ndërsa yield-et e obligacioneve të thesarit kanë rënë, obligacionet e korporatave, në përgjithësi, janë përballur me një trend rritës gjatë muajit, për shkak të pasigurive në mjedisin ekonomik dhe ndjesisë së riskut si rezultat i shfaqjes së variantit Omicron të Covid-19. Kjo ka shkaktuar një rivlerësim negativ të portofolit të investimeve. Gjithsesi, fondi Euro është fokusuar kryesisht në investime afatmesme, në mënyrë që të jetë i kujdesshëm ndaj rrezikut të normave të interesit.

**Kthimi neto vjetor rezultoi në nivelin -0.91% më 30 Nëntor 2021.**



Ne dt 30 Nëntor 2021	1 Vit	2 Vite	3 Vite	5 Vite	7 Vite	Nga lancimi (22 Nentor 2012)
Kthimi ne % p.a per periudhen	<b>-0.91%</b>	<b>-1.18%</b>	<b>0.45%</b>	<b>0.59%</b>	<b>1.20%</b>	<b>1.73%</b>

## Kthimi Neto i fondit Raiffeisen Invest Euro per çdo vit



Duhet patur parasysh se norma e kthimit ndryshon në varësi të kushteve të tregut dhe çmimi i kuotës mund të jetë i luhatshtëm, pra nuk është statik apo gjithmonë në rritje, por edhe mund të bjerë si pasojë e ndryshimeve të kushteve në treg. Luhatshmëria është pjesë e natyrshme e fondeve të investimit dhe eliminimi total i saj është i pamundur.

Investitorët e fondit Raiffeisen Invest Euro dhe të gjithë fondet e administruara nga Raiffeisen Invest keshillohen të kenë një horizont sa më të gjatë investimi për të përfituar një kthim optimal nga investimi dhe në këtë mënyrë në periudhë afatmesme apo afatgjatë të kenë mundësi të rikuperojnë edhe efektet negative të krijuara afatshkurter.

Investitorët inkurajohen që të ruajnë investimin e tyre duke mos ndryshuar objektivin e qëndrimit në fond të nxitur nga situata jo e zakonshme e krijuar nga pandemia globale, sepse në këtë mënyrë nuk do të rrezikojnë të dalin nga fondi në momentin e gabuar për investimin e tyre.

## Zhvillimet dhe informacion mbi ecurinë e tregjeve financiare gjatë muajit Nëntor

Situata e pandemisë është bërë përsëri shumë shqetësuese, pasi moti më i ftohtë ka shkaktuar një rritje të numrit të rasteve në Evropë, ndërsa SHBA-të janë gjithashtu në rrezik të një rritjeje sezonale. Austria ka hyrë në një karantinë ndërkombëtare dhe duke e bërë këtë, ajo bëhet vendi i parë i Evropës Perëndimore që vendos kufizime të gjera, pasi kufizimet ndaj personave të pavaksinuar nuk arritën të frenojnë një shpërthim të infeksioneve të reja. Gjermania nuk po përjashton më një lëvizje të ngjashme pasi Evropa po përballet me një valë të katërt të pandemisë së koronavirusit. Edhe nëse shtetet e tjera vendosin më pak kufizime, pasiguria e konsumatorëve mund të nënkuptojë se eurozona në tërësi do të ngadalësojë rritjen ekonomike në tremujorin e katërt. Omicron, një variant i ri i koronavirusit u identifikua në Afrikën e Jugut dhe raste të këtij varianti janë konfirmuar edhe në shtete të tjera. Frika se varianti i ri mund të nxisë rritje të rasteve në shumë vende, duke ulur efektivitetin e vaksinave dhe duke komplikuar përpjekjet për të rihapur ekonominë dhe kufijtë, shkaktoi një valë shmangëse ndaj riskut në tregjet globale. Më vonë ato u qetësuan, pasi nga studiuesit u arrit në përfundimin se vaksina ishte efektive edhe për këtë variant.

Përveç pandemisë, ka pasur shqetësime të tjera në tregje në lidhje me inflacionin e lartë dhe perspektivën e përfundimit më të shpejtë të politikave monetare zgjeruese. Rritja e inflacionit total nga 4.1% në Tetor në 4.9% në Nëntor ishte një tjetër surprizë. Më i rëndësishmi për BQE-në, inflacioni bazë (i cili përjashton energjinë, ushqimin, alkoolin dhe duhanin), gjithashtu u rrit në një nivel rekord prej 2.6%. Të dhënat më të fundit sugjerojnë se presionet mbi çmimet mbeten intensive, inflacioni i çmimeve të prodhuesve mbetet i fortë dhe pritshmëritë e firmave për çmimet e shitjes janë jashtëzakonisht të larta.

Siç pritej gjerësisht, zvogëlimi i blerjeve u njoftua më në fund në takimin e Nëntorit të Rezervës Federale, por sa i përket normave, rritja e dobët e PBB-së mund të nënkuptojë se FED do t'i rrisë ato më vonë sesa investitorët kishin parashikuar. Pritshmëritë për rritjen e normës së interesit nuk janë intensifikuar gjatë Nëntorit dhe tani rritja e parë e normave të interesit në SHBA është çmuar në mesin e vitit 2022.

Ndërsa BQE do të përfundojë programin e blerjeve emergjente në Mars, ajo do të rrisë ritmin e blerjeve të aktiveve të saj konvencionale në 2022 dhe ka shumë të ngjarë të lërë normat në pritje deri në vitin 2025. Tregtarët i kanë shtyrë bastet për rritjen e parë të normës së Bankës Qendrore Evropiane deri në 2023, një shenjë se ata po ia vënë veshin mesazhit për durim të politikëbërësve.

Tregjet e obligacioneve ishin të paqëndrueshme gjatë Nëntorit me rritje të ndjesisë së riskut si rezultat i shfaqjes së variantit Omicron të Covid-19. Një qasje drejt investimeve më të sigurta bëri që yield-et e obligacioneve të thesarit të bien dhe, në përgjithësi, yield-et e obligacioneve qeveritare afatgjata ranë. Lëvizja shmangëse e riskut u reflektua edhe në obligacionet e korporatave. Obligacionet në gradë investimi patën kthime totale të sheshta dhe performancë më të dobët se obligacionet qeveritare. Obligacionet në gradë investimi ranë dhe spread-et u zgjeruan thellë, sidomos në javën e fundit të muajit.

Në vazhdim, në datën 23 Nëntor, qeveria e Republikës së Shqipërisë emtoi Eurobondin e paralajmëruar 10-vjeçar me një normë kuponit 3.50% dhe një yield prej 3.75%. Nga tregu u morrën borxh 650 milionë euro, ndërsa oferta ka qenë 1.8 herë më e lartë në vlerën 1.2 miliardë euro.

Të dhënat e kthimit nga investimi në të shkuarën janë vetëm ilustrative dhe nuk përfaqësojnë një premtim apo garanci për kthimin në të ardhmen. Të gjithë shembujt e tjerë numerikë janë përdorur për qëllime ilustrative dhe analizë të të dhënave historike, dhe nuk duhen përdorur nga investitorët për të nxjerrë konkluzione për të ardhmen. Investitorët e mundshëm duhet të lexojnë Prospektin dhe Rregullat e Fondit. Raiffeisen Invest dhe forca shitëse e fondit nuk garantojnë një kthim të caktuar të fondit.

Informacioni mbi çmimin e përditësuar të kuotës, prospektin dhe rregullat e Fondit gjendet pranë zyrave të Raiffeisen Invest sha., në faqen zyrtare [www.raiffeisen-invest.al](http://www.raiffeisen-invest.al) ose në degët e Raiffeisen Bank në Shqipëri.